



СЛУЖБА КООРДИНАЦИОНОГ ТЕЛА ВЛАДЕ РЕПУБЛИКЕ СРБИЈЕ
ЗА ОПШТИНЕ ПРЕШЕВО, БУЈАНОВАЦ И МЕДВЕЂА

SHËRBIMI I TRUPIT KOORDINUES I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË
PËR KOMUNAT PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

**ИНФОРМАТИВНА БРОШУРА О МЕХАНИЗМУ
ПАСИВИЗАЦИЈЕ АДРЕСА ПРЕБИВАЛИШТА**

**BROSHURË INFORMUESE MBI MEKANIZMIN
E PASIVIZIMIT TË ADRESËS SË VENDBANIMIT**

ПАСИВИЗАЦИЈА АДРЕСЕ ПРЕБИВАЛИШТА У РЕПУБЛИЦИ СРБИЈИ

Информативна брошура

Ова брошура је намењена информисању грађана о поступку пасивизације адресе пребивалишта, његовим последицама и правним средствима која вам стоје на располагању за заштиту ваших права.

1. Шта је пасивизација адресе пребивалишта?

Пасивизација адресе пребивалишта регулисана је Законом о пребивалишту и боравишту грађана који се примењује једнако на целој територији Републике Србије и на све њене грађане.

Пасивизација адресе пребивалишта је административна мера којом надлежни орган (Министарство унутрашњих послова – МУП) у службеној евиденцији врши означавање да грађанин не станује на адреси на којој је пријављено пребивалиште.

Сврха пасивизације адресе пребивалишта није усклађивање права, већ успостављање реда, тачности и правне сигурности која штити како грађане и њихову имовину, тако и државу и њене институције.

2. Када долази до пасивизације адресе?

До поступка пасивизације долази када се посумња да грађанин не живи на адреси пријављеног пребивалишта. То се најчешће дешава:

- На захтев власника непокретности који жели да одјави лице које више не живи у његовом стану/кући,
- На захтев судова и других државних органа и организација.

Важно:

Пасивизација се не спроводи аутоматски. У складу са Законом о пребивалишту и боравишту грађана и Законом о општем управном поступку, пре доношења решења о пасивизацији спроводи се званични управни поступак. Полиција је дужна да изврши теренску проверу ради утврђивања чињенице да ли лице стварно живи на адреси на којој има пријављено пребивалиште и утврди чињенице, као и да омогући грађанину да учествује у поступку и изјасни се о чињеницама пре него што се донесе коначна одлука.

PASIVIZIMI I ADRESËS SË VENDBANIMIT NË REPUBLIKËN E SERBISË

Broshurë Informuese

Kjo broshurë është përgatitur për t'i informuar qytetarët lidhur me procedurën e pasivizimit të adresës së vendbanimit, pasojat e saj dhe mjetet juridike që keni në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave tuaja.

1. Çfarë është pasivizimi i adresës së vendbanimit?

Pasivizimi i adresës së vendbanimit rregullohet me Ligjin për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve, i cili zbatohet në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin e Republikës së Serbisë dhe për të gjithë qytetarët e saj. Pasivizimi i adresës së vendbanimit është një masë administrative me të cilën organi kompetent (Ministria e Punëve të Brendshme – MPB) në evidencën zyrtare kryen shënimin se qytetari nuk banon në adresën ku e ka të regjistruar vendbanimin. Qëllimi i pasivizimit të adresës së vendbanimit nuk është kufizimi i të drejtave, por vendosja e rendit, saktësisë dhe sigurisë juridike, e cila mbron si qytetarët dhe pronën e tyre, ashtu edhe shtetin dhe institucionet e tij.

2. Kur ndodh pasivizimi i adresës?

Procedura e pasivizimit fillon kur lind dyshimi se qytetari nuk jeton në adresën e vendbanimit të regjistruar. Kjo ndodh më së shpeshti:

- Me kërkesë të pronarit të paluajtshmërisë, i cili dëshiron ta ç'regjistrojë personin që nuk jeton më në banesën apo shtëpinë e tij;
- Me kërkesë të gjykatave dhe organeve apo organizatave të tjera shtetërore.

Me rëndësi:

Pasivizimi nuk bëhet automatikisht. Në përputhje me Ligjin për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, para marrjes së vendimit për pasivizim zhvillohet procedurë zyrtare administrative. Policia është e obliguar të kryejë verifikim në terren për të konstatuar nëse personi jeton realisht në adresën ku e ka të regjistruar vendbanimin, të vërtetojë faktet dhe t'i mundësojë qytetarit të marrë pjesë në procedurë dhe të deklarohet mbi faktet përpara se të merret vendimi përfundimtar..

3. Какве су последице и како то утиче на ваша права?

Пасивизирана адреса може озбиљно отежати или привремено онемогућити свакодневни живот и остваривање основних права. Док се статус не реши, последице укључују:

- Немогућност издавања личних докумената: Нећете моћи да извадите личну карту или пасош уколико вам је адреса пасивизирана.
- Проблеми са социјалном заштитом: Отежано је остваривање права на дечији додатак, социјалну помоћ и друге локалне субвенције.
- Проблеми са доставом писама, што може довести до пропуштања рокова и правних последица.

Због тога је важно да благовремено пријавите пребивалиште на адреси на којој стварно живите.

4. Да ли је могућа поновна пријава на пасивизираној адреси?

Да, могућа је. Ако је ваша адреса пасивизирана, а ви сте се вратили да живите на њој, имате право да поднесете захтев за пријаву пребивалишта на истој адреси.

Да бисте то урадили, потребно је да надлежној полицијској управи/станици поднесете:

1. Доказ о правном основу коришћења стамбене јединице (на пример власнички лист, уговор о купопродаји стана, уговор о поклону стана, правоснажно оставинско решење и др.) и сагласност власника уколико се пријава врши на адреси туђе стамбене јединице.
2. Важећу личну карту и попуњен образац пријаве.

Након подношења захтева, обавезно се врши провера да ли заиста живите на тој адреси.

3. Cilat janë pasojat dhe si ndikojnë ato në të drejtat tuaja?

Adresa e pasivizuar mund ta vështirësojë seriozisht ose përkohësisht ta pamundësojë jetën e përditshme dhe ushtrimin e të drejtave themelore. Derisa statusi të zgjidhet, pasojat mund të përfshijnë:

- Pamundësinë e pajisjes me dokumente personale: Nuk do të mund të pajiseni me letërnjoftim ose pasaportë nëse adresa juaj është pasivizuar.
- Probleme në realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale: Vështirësohet realizimi i të drejtës për shtesën e fëmijëve, ndihmën sociale dhe subvencione të tjera lokale.
- Probleme me pranimin e dërgesave postare, gjë që mund të çojë në humbjen e afateve dhe pasoja juridike.

Për këtë arsye është e rëndësishme që ta regjistroni me kohë vendbanimin në adresën ku jetoni realisht.

4. A është i mundur regjistrimi sërish në adresën e pasivizuar?

Po, është i mundur. Nëse adresa juaj është pasivizuar, por ju jeni kthyer të jetoni në të, keni të drejtë të paraqisni kërkesë për regjistrimin e vendbanimit në të njëjtën adresë.

Për këtë duhet të paraqisni në administratën policore ose stacionin kompetent të policisë:

1. Dëshmi mbi bazën juridike të përdorimit të njësisë banesore (për shembull: fletëpronësinë, kontratën e shitblerjes së banesës, kontratën mbi dhuratën e banesës, aktvendimin e formës së prerë mbi trashëgiminë etj.), si dhe pëlqimin e pronarit nëse regjistrimi bëhet në adresën e një njësie banesore që nuk është në pronësinë tuaj.
2. Letërnjoftimin e vlefshëm dhe formularin e plotësuar të regjistrimit.

Pas paraqitjes së kërkesës, do të kryhet verifikim për të konfirmuar nëse jetoni realisht në atë adresë.

5. Правни лекови: Како се заштитити?

Против решења о пасивизацији пребивалишта, на располагању су вам следећи правни кораци у складу са Законом о пребивалишту и боравишту грађана и Законом о општем управном поступку (ЗУП):

- Жалба на решење о пасивизацији: против решења о пасивизацији имате право да поднесете жалбу у року од 8 дана од дана пријема решења. Жалба се предаје преко полицијске управе/станице која је донела решење (може се изјавити и усмено на записник), а о њој одлучује другостепени орган (Министарство унутрашњих послова). Кључно је поднети жалбу на време.
- Покретање управног спора: Уколико МУП одбије вашу жалбу, имате право да у року од 30 дана од пријема другостепеног решења покренете управни спор пред Управним судом Републике Србије ради преиспитивања законитости коначне одлуке.

6. Важне напомене за грађане

Пасивизација адресе није казнена мера.

Сваки случај се разматра појединачно.

Ваша законска обавеза је да пријавите пребивалиште на адреси на којој стверно живите у року од 8 дана од дана настањења на тој адреси.

7. Где грађани могу добити додатне информације?

Надлежна полицијска управа или станица (МУП): Одељења/Одсеци за управне послове.

На званичној интернет презентацији Министарства унутрашњих послова.

5. Mjetet juridike: Si të mbroni të drejtat tuaja?

Kundër aktvendimit për pasivizimin e vendbanimit keni në dispozicion këto mjete juridike, në përputhje me Ligjin për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e Qytetarëve dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative:

- Ankesë kundër aktvendimit për pasivizim: Keni të drejtë të paraqisni ankesë brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit. Ankesa dorëzohet përmes administrates policore ose stacionit të policisë që ka sjellë aktvendimin (mund të paraqitet edhe gojarisht në procesverbal), ndërsa për të vendos organi i shkallës së dytë – Ministria e Punëve të Brendshme. Është me rëndësi që ankesa të paraqitet brenda afatit ligjor.
- Ngritja e kontestit administrativ: Nëse MPB-ja e refuzon ankesën tuaj, keni të drejtë që brenda 30 ditëve nga pranimi i aktvendimit të shkallës së dytë të ngrini kontest administrativ para Gjykatës Administrative të Republikës së Serbisë për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit përfundimtar.

6. Shënime të rëndësishme për qytetarët

Pasivizimi i adresës nuk është masë ndëshkuese.

Çdo rast shqyrtohet veçmas.

Obligimi juaj ligjor është ta regjistroni vendbanimin në adresën ku jetoni realisht brenda 8 ditëve nga dita e vendosjes në atë adresë.

7. Ku mund të marrin qytetarët informata shtesë?

Në administratën policore ose stacionin kompetent të policisë (MPB) – Departamenti/Spektori për Punë Administrative.

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

